



Lajmet e Fundit: Maliq – Drejtonin mjetin në mënyrë të parregullt, arrestohen në flagrancë 2 shtetas



Lajmet Operacionet

10/02/2022

Gjirokastrë – Finalizohet operacioni policor i koduar “LAST WINTER”

Operacioni nga Komisariati i Policisë Gjirokastrë, në bashkëpunim me Seksionin për Hetimin e Trafikeve dhe Narkotikëve dhe Seksionin Operacional në DVP Gjirokastrë.

Skuestrohen 2 armë zjarri, municion luftarak dhe pajisje të ndryshme që përdoren për kultivimin e bimëve narkotike në ambiente të mbyllura.

Vihet në pranga poseduesi.

Në vijim të punës së pandërprerë për parandalimin dhe goditjen e paligjshmërisë, kapjen dhe vënien përpara përgjegjësisë ligjore të personave që mbajnë armë zjarri pa leje, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë, në bashkëpunim me Seksionin për Hetimin e Trafikeve të Paligjshme dhe Narkotikëve dhe Seksionin Operacional në DVP Gjirokastrë, mbi bazën e informacioneve të siguruara në rrugë policore se shtetasi M. S. dispononte armë zjarri dhe mjete të teknologjisë së lartë që shërbejnë për kultivimin e bimëve narkotike në ambiente të mbyllura, kanë organizuar dhe finalizuar me sukses operacionin policor të koduar “LAST WINTER”, si rezultat i të cilit u arrestua në flagrancë shtetasi M. S., 62 vjeç, banues në fshatin Lazarat, Gjirokastrë.

Gjatë kontrollit të banesës së këtij shtetasi, shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar 2 armë zjarri pistoleta, 10 krehra, 157 fishekë dhe pajisje që përdoren për kultivimin e bimëve narkotike në ambiente të mbyllura, si: 26 përforcues energjie elektrike, 2 filtra që shërbejnë për pastrimin e ajrit, 7 tuba që shërbejnë për ventilimin e ajrit, llamba dhe projektorë që shërbejnë për transferim nxehtësie, 4 ngrohëse me gaz dhe pajisje të tjera elektrike.

Gjithashtu, në banesën e këtij shtetasi u konstatua lidhje e paligjshme e energjisë elektrike.

Materialet në ngarkim të shtetasit M. S. i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, për veprat penale “Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, “Përdorimi i paligjshëm i teknologjisë së lartë” dhe “Vjedhja e energjisë elektrike”.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

Share

Share

Share

Share

Email

◀ Dibër – Finalizohet operacioni policor i koduar “Gaminator”, në pranga 2 shtetas

Elbasan – Arrestohen në flagrancë 3 shtetas, për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” ▶